



Nr 38/i Prot, dt 28.12.2022

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËS PUBLIKE  
DREJTORIA E ADMINISTRIMIT TË PRONËS SHTETËRORE

Nr. 23965/1 Prot.

Tiranë, më 28/12.2022

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE**

Nr. 12 / Datë 28.12.2022  
PËR

**ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “KORPORATA E INVESTIMEVE SHQIPTARE” SHA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjit Nr. 71, datë 17.10.2019 “Për korporatën e Investimeve Shqiptare”, Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit”, Aktit Normativ nr.17, datë 01.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Korporata e Investimeve Shqiptare” sha Tiranë;

**VENDOSA:**

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë për vlerën 2,000,000,000 (dy miliardë) lekë, kaluar me Aktin Normativ nr.17, datë 01.12.2022.
2. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” ngarkohet Shoqëria “Korporata e Investimeve Shqiptare” sha Tiranë, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

**Delina IBRAHIMAJ**





Nr. 23966/1 Prot.

Tiranë, më 28.12.2022

**VENDIM I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONARËVE**

Nr. 113/1, Datë 28.12.2022

**PËR  
ZMADHIMIN E KAPITALIT TË SHOQËRISË “KORPORATA E INVESTIMEVE  
SHQIPTARE” SHA TIRANË**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” i ndryshuar, Ligjit Nr. 71, datë 17.10.2019 “Për Korporatën e Investimeve Shqiptare”, Ligjit Nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Regjistrimin e Biznesit” dhe Aktit normativ nr.17, datë 01.12.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë “Korporata e Investimeve Shqiptare” sha Tiranë;

**VENDOSA:**

1. Zmadhimin e kapitalit themeltar të shoqërisë “Korporata e Investimeve Shqiptare” sha Tiranë për vlerën 120,000,000 (njëqind e njëzet milionë) lekë.
2. Bazuar në Ligjin 9723, datë 03.05.2007, “Për regjistrimin e biznesit” ngarkohet shoqëria “Korporata e Investimeve Shqiptare” sha Tiranë, për kryerjen e veprimeve lidhur me ndryshimet përkatëse në regjistër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR**

**Delina IBRAHIMAJ**

